

GJYKATA E QARKUT NË PEJË/PEĆ

P.Nr.268/2008
1 Korrik 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT TË PEJËS/PEĆ, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi Ndërkombëtar i EULEX-it Ferdinando Buatier de Mongeot si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjykatësi Ndërkombëtar i EULEX-it Gianfranco Gallo dhe Gjykatësi Kosovar Haxhi Dërguti si anëtar të trupit gjykues, të ndihmuar nga procesmbajtësja Vlora Johnston, në rastin penal kundër të akuzuarve

BEKIM ZEKA, djali i Sherifit dhe i Hanifes, mbiemri vajzëror Morina, i lindur me 01/12/1975 në Abri e Poshtme, Komuna e Skenderajt, aktualisht banor në rrugën “28 Nëntori” në Skenderaj, ka kryer shkollën fillore, i martuar dhe ka dy fëmijë, i gjendjes së dobët financiare, Shqiptar, shtetas Kosovës, në paraburgim nga 27/07/2008.

DHE

ARBEN ZEKA, djali i Sherifit dhe i Hanifes, mbiemri vajzëror Morina, lindur me 02/05/1977 në Abri të Poshtme, Komuna e Skenderajt, aktualisht banor në fshatin Murgë, Komuna e Skenderajt, ka kryer shkollën fillore, i pamartuar, me gjendje të dobët financiare, Shqiptar, shtetas i Kosovës, në paraburgim nga 27/07/2008.

Të akuzuar për veprat penale në vijim:

Vrasje e kryer në bashkëfajësi për përfitim personal (në përputhje me Nenin 30, par.2, pika 3 e Ligjit Penal të Kosovës i vitit 1977, në lidhje me nenin 22 të LPJ) e Ejup Broqi-t, kryer në Cerovik (Klinë) në një datë të papërcaktuar kah fundi i Qershorit 1999.

Në veçanti të pandehurit, në ekzekutimin e planit të tyre për vrasjen e një vozitësi Serb/Rom të taksisë me qëllim që t'i marrin atij veturën dhe gjërat e detyruan dëshmitaren Teuta Hoti të vishet me uniformë ushtarake dhe në këtë mënyrë e shtyen viktimën Ejup Broqi, një vozitës të taksisë, që t'i dërgoj ata në fshatin Gllobare në Drenas me veturën e tij Opel Ascona, me ngjyrë të kuqe. Pasi që arritën në fshatin Cerovik, i pandehuri Arben Zeka, e kapi viktimën për fyti. Të dy të pandehurit më pas filluan ta rrahin atë, duke e tërhjekur zvarrë jashtë veturës në drejtim të pyllit, ku pas disa minutave e e qëlluan dy herë me revole në pronësi të Bekim Zekës, dhe kësisoji shkaktuan vdekjen e tij. Të pandehurit mëpastaje morrën veturën e viktimës dhe portofolin e tij.

Krim që dënohet nga dhjetë deri në njëzet vjet burgim.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesëor publik me 15, 16, 18 dhe 30 Qershor, dhe 1 Korrik, në prani të:

- të akuzuarit Arben Zeka dhe Bekim Zeka dhe mbrojtësve të tyre Z. Zenel Mekajt dhe Abit Asllanaj (apo zëvendësuesve të tyre);
- Prokurorit Publik Gëzim Kollçaku (apo zëvendësuesit të tij);
- Palës së dëmtuar Znj. Shukrije Broqi,

Pas shqyrtimit nga trupi gjykues dhe votimit të mbajtur me 30 Qershor 2009, bazuar në Nenin 391 Paragrafi (1) i KPPK, me 1 Korrik 2009, në përputhje me Nenin 392 Paragrafi (1) i KPPK, bën publik dhe në prani të të akuzuarve shpall këtë:

AKTGJYKIM

ARBEN ZEKA dhe BEKIM ZEKA janë

GJETUR FAJTOR

Për veprën penale të vrasjes, e kryer në bashkëfajësi për përfitim personal, të Ejup Broqit, në përputhje me Nenin 30, par. 2, pika 3 e Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977, në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Jugosllavisë. Krim që është kryer në fshatin Cerovik në një datë të papërcaktuar në fund të Qershorit 1999;

Andaj:

I akuzuari **BEKIM ZEKA**

DËNOHET

Me njëzet (20) vjet burgim për veprën e përmendur penale;

I akuzuari **ARBEN ZEKA**

DËNOHET

Me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim për veprën e përmendur penale.

Koha e kaluar në paraburgim duhet të llogaritet në dënimin e shqiptuar, në përputhje me Nenin 391 Paragrafi (1) Nën-paragrafi 5 i KPPK-së.

Në përputhje me Nenin 102 Paragrafi (1) i KPPK-së, të pandehurit duhet të kompenzojnë shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Një vendim i veçantë mbi vlerën e shpenzimeve do të silllet nga gjykata në kohën kur shënimet e tilla të sigurohen në përputhje me Nenin 100 Paragrafi (2) i KPPK-së.

Në përputhje me nenin 112, paragrafi 2 i KPPK-së, secili nga të pandehurit

NDËSHKOHET

që t'i paguaj shumën e 10.000,00 (dhjetë mijë) € palës së dëmtuar Shukrije Broqi si kompenzim i pjesshëm për dëmin e pësuar. Gjykata në këtë mënyrë e udhëzon palën e dëmtuar që ajo mund të paraqes kërkesë pasurore për pjesën e mbetur te pronës në kontestin civil.

ARSYETIM

1. Sfondi dhe hapat procedural

Në fund të muajit Qershor 1999 Ejup Broqi, një taksist nga Peja, burri i Shukrije Broqi-t u zhduk.

Pas hulumtimeve të gjata nga anëtarët e familjes, një trup ishte gjetur në afërsi të fshatit Cerovik (Komuna e Klinës). Trupi u identifikua të jetë i Ejup Broqi-t nga vëllau i viktimës dhe i ishte dhënë prapa familjes, të cilët e varrosen viktimën (shih "Përmbledhja e rastit" e datës 21.6.2004 dhe deklaratat e dhëna policisë nga Gzim Broqi me 31.03.03, të konsideruara si të lexuara nga palët në ndëgjimin e datës 16.6.2009).

Vrima hyrëse e plumbit ishte e dukshme në qafën e kufomës dhe vrima dalëse ishte në fyt¹.

Së pari hetimet ishin të pakuptimta, veqanërisht në saje të kushteve socio-politike në Kosovë në atë kohë.

Duhet të shtohet se vetëm pas tre/katër vjeteve familja vendosi që t'a raportoj rastin në mënyrë zyrtare në Stacionin Policor²: megjithatë hetimet në mënyrë esenciale ishin në situatë pa rrugëdalje dhe mbeten ashtu deri në Korrik 2008, kur një ngjarje e papritur e zhbllokoi qorrsokakun.

Vërtetë me 27 Korrik 2008 Sherif Zeka, babai i të pandehurve, i raportoi Policisë vjedhjen e veturës së tij, të pretenduar nga djemtë Bekimi dhe Faruku. Nga aty procedura penale n.2008 Bf 0874 ishte filluar.

Me rastin e raportit të tij lidhur me vjedhjen, i kërkuar të thotë se çfarë lloj njerzish djemtë e tij Bekimi dhe Faruku ishin, dhe nëse ata kishin apo nuk kishin kryer ndonjë krim tjetër para vjedhjes, Sherif Zeka shtoi si në vijim: *"Rreth një vjet pas luftës (1999) sa më kujtohet ishte verë; djemtë e mi Faruku dhe Bekimi e morrën një taksist nga Peja, nuk ia di emrin atij, dhe e sollën atë në Cerovik të Komunës së Klinës; e plaqkitën atë dhe e vranë duke ia këputur kokën dhe mëpastaj e hodhën në pyll, ia morën atij Asconën e kuqe që ai e mbajti për një kohë. Unë nuk e di për sa gjatë ai e voziti atë në Pejë, dhe gjithkrah në Kosovë"*³

¹ Shih përsëri deklaratat e Ejup Broqi-t, i cili në këtë aspekt i kujtohet se vlerësimi ishte bërë nga Dr. Isa Kalijani ditën e njejtë kur ishte zbuluar kufoma.

² Një përmbledhje e rastit mund të gjendet në të dyjat në "Përmbledhjen e rastit" të datës 21.6.2004 dhe në "Raportin e Policit" të datës 28/7/2008, që gjenden në dosjen e rastit.

³ Shih deklaratat e bëra nga Sherif Zeka me 27.7.2008 në Stacionin Policor në Skenderaj.

Kështu që hetimet për vrasjen morrën një moment tjetër, duke vërë në cak fillimisht Bekim dhe Faruk Zekën.

Pas marrjes në pyetje të dëshmitarës Teuta Hoti, falë një korrigjimi nga Sherif Zeka doli se Faruku nuk ishte i përfshirë në kryerjen e krimit. Në vend të Farukut ishte hetuar Arben Zeka, sepse Teuta Hoti tregoi se ai ishte bashkëpjesmarrës i Bekim Zekës në vrasje.

Me 27.07.2008 Bekim Zeka dhe Arben Zeka ishin arrestuar.

Me 29.07.2008 Policia e Kosovës parashtroi një kallëzim penal në Prokurorinë e Qarkut kundër të dy të pandehurve, që ishte pasuar ditën e njejtë me një vendim mbi fillimin e hetimit dhe një kërkesë për paraburgim ishte parashtruar.

Me 20 tetor 2008 Prokurori Publik parashtroi aktakuzën PP.nr.259/2008 në Gjykatën e Qarkut të Pejës/Pec, kundër të Pandehurve Bekim Zeka dhe Arben Zeka, duke i akuzuar ata për veprën penale të vrasjes në bashkëfajësi në përputhje me nenin 30, par.2, pika 3 e LPK-së.

Sipas aktakuzës, në një ditë të pakonfirmuar, kah fundi i muajit Qershor i 1999 në fshatin Cerovik, Komuna e Klinës, me dashje dhe me qëllim që të arrijnë përfitime financiare për vehtveten, të pandehurit e vranë Ejup Broqi-n nga Peja, i moshës 46 vjeqare.

Me këto veprime të akuzuarit kryen veprën penale në bashkëfajësi sipas nenit 30, par.2, pika 3 e LPK, e dënueshme me burgim jo më pak se dhjetë (10) vjet dhe jo më shumë se njëzet (20) vjet, në përputhje me seksionin 1.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 1999/24.

Ndëgjimi mbi konfirmimin e aktakuzës ishte mbajtur me 20 Nëntor 2008, në prani të të pandehurve, mbrojtësve të tyre dhe prokurorit publik; duke konfirmuar aktakuzën me aktvendimin KAQ.nr.316/08 të datës 20 Nëntor 2009.

Shqyrtimi kryesor ishte mbajtur publikisht me 15, 16, 18, 30 Qershor dhe 01 Korrik 2009, në prani të të akuzuarit Bekim Zeka, mbrojtësit të tij Abit Asllani, të akuzuarit Arben Zeka, mbrojtësit të tij Zenel Mekaj, Prokurorit Publik Gëzim Kollcaku dhe palës së dëmtuar Shukrije Broqi.

Në pajtim me nenin 15 të KCCP, përkthyesit ndërkombëtar përkthyen procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore relevante për gjykimin në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

Gjatë shqyrtimit kryesor personat në vijim ishin ndëgjuar:

- a) Teuta HOTI si dëshmitare me 15 korrik 2009
- b) Sherif ZEKA si dëshmitar me 16 korrik 2009
- c) Driton AVDIU si dëshmitar me 16 korrik 2009
- d) Faruk ZEKA si dëshmitar me 16 korrik 2009
- e) Gani MORINA si dëshmitar me 18 korrik 2009

Të Pandehurit ishin marrë në pyetje me 18 qershor 2009.

Pas marrëveshjes nga palët, deklaratat në vijim ishin konsideruar si të lexuara në shqyrtimin kryesor:

- deklaratat e bërë nga pala e dëmtuar Shukrije Broqi përpara Prokurorit Publik me 15 Shtator 2008.
- deklaratat e bëra nga Qerim Camaj përpara Policisë me 27 Maj,2004.
- deklaratat e bëra nga Arif Arifaj përpara Policisë me 20.1.2004;
- deklaratat e bëra nga Gzim Broqi përpara Policisë me 31.3.2003.

Aktgjykimi ishte lexuar me zë publikisht në ndëgjimin e 1 qershorit 2009. Ditën e njëjtë paraburgimi ishte vazhduar deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

2. Ligji i aplikueshëm, kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues

2.1 Të pandehurit janë të akuzuar për vrasje të rëndë sipas nenit 30, par.2, n 3 , i Ligjit penal të Kosovës. Vepra e tillë është e dënueshme me burgim prej jo më pak se dhjetë

(10) vjet dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjet, sipas seksionit 1.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 1999/24. Burgimi prej njëzet(20) vjetëve është poashtu i mundshëm për rastet më të rënda.

Trupi gjykues pajtohet me Prokurorin Publik se ligji i aplikueshëm esencial është Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977 siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 24/99.

Në fakt:

- vrasja e Ejup Broqit ndodhi në fund të Qershorit të 1999.
- Ligji i aplikueshëm substancial duhet të jetë ai që ishte në fuqi në kohën kur krimi ishte kryer, përveq nëse një ligj më i favorshëm kishte hyrë në fuqi më pas (neni 2 i Ligjit Penal Të Kosovës, identik me Ligjin penal të Jugosllavisë në lidhje me këtë çështje);
- Ligji në fuqi në kohën e kryerjes së krimit ishte Ligji Penal i Kosovës nga 1977. Neni i tij 30, par.2, i themeluar për dënimin e krimit të rëndë me burgim me së paku 10 vjet apo dënim me vdekje (që pas rregullores së PSSP 24/1999, ishte transformuar në burgim mes minimum 10 dhe 15 vjet, apo burgim prej 20 vjetëve).
- Se Kodi Penal i Kosovës që hyri në fuqi me 2004, dënon (neni 147, par.3) krimin e njëjtë me burgim nga së paku 10 vjet apo me burgim afatgjatë (psh. Privim i lirisë në mes 21 dhe 40 vjetëve)

Prej aty Kodi Penal i Kosovës (2004) nuk është më i favorshëm dhe andaj Ligji Penal i Kosovës (1977), në lidhje me Kodin Penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë, aplikohet në rastin aktual.

2.2 Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës(këtu e tutje KPPK), Gjykatat e Qarkut do të kenë jursidksionin për të gjykuar në shkallën e parë veprat e dënueshme me burgim nga së paku pesë vjet apo me burgim afatgjatë.

Gjykata e Qarkut e Pejës/Pec është kompetente territorialisht , pasi qe fshatë Cerovik është brenda Komunës së Klinës që bie nën jursidksionin e Gjykatës së Qarkut të Pejës/Pec.

2.3 Vepra bie brenda fushëveprimit të nenit 3, par.3, i Ligjit mbi Jurisdksionin (3-L053/2008), që paraqet kompetencën subsidiare të Gjykatësve të EULEX-it.

Neni 3, par.3 thotë se në rastet e kompetencës subsidiare Gjykatësit e EULEX-it mund të marrin përsipër një rast pas caktimit nga Kryetari i Gjykatësve të EULEX-it, në vijim të kërkesës nga cilado palë e procedurës apo nga Gjykatësi i Gjykatës përkatëse, për çfarëdo arsye kur kjo konsiderohet e nevojshme për administrimin e drejtë të drejtësisë.

Në këtë rast, dy gjykatës të EULEX-it janë caktuar nga Kryetari i Gjykatësve të EULEX-it me datë 8.4.2009, pas një kërkesë nga UD i Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Pejës për të zëvendësuar gjykatësit vendor me gjykatës të EULEX-it.

Një gjykatës Kosovare ka qenë pjesë e trupit gjykues gjatë tërë gjykimit në përputhje me nenin 4.7 të Ligjit mbi Jurisdksionin.

Duhet të shtohet se *in limine litis* palët nuk patën asnjë vërejtje ndaj përbërjes së trupit gjykues.

3. Meritat e rastit

Në baza të dëshmive të mbledhura Trupi gjykues mendon se fajësia e Arben dhe Bekim Zekës është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Shtylla e kornizës së tërësisë së provave kundër të pandehurve është ofruar nga Sherif Zeka, Teuta Hoti dhe Faruk Zeka.

Një kontribut më i pakët është ofruar nga dëshmitarët Gani Morina dhe Driton Avdiu.

Të pandehurit vetvetiu ofruan, në nivelin i cili do të paraqitet më poshtë, vërtetim të deklaratave të dëshmitarëve që i akuzuan ata.

3.1 Sherif Zeka

Deklaratat e bëra nga Sherif Zeka janë të rëndësishme për gjykimin e rastit, sepse vetëm falë atyre hetimi mund të rifillohej dhe të pandehurit të zbulohen.

Me rastin e ndëgjimit para trupit gjykues dëshmitari qartë tentoi të tërhiqet prapa nga deklaratat e tij të bëra përpara hetuesve, ku ai kishte akuzuar dy djemtë për vrasjen e vozitësit të taksisë. Kjo e obligoi trupin gjykues të konfrontoj dëshmitarin me deklaratat e tij të mëhershme dhe më pas, duke pasë kujdesin më të madh, të vlerësoj se cili nga verzionet është më i besueshmi (dhe në cilat pjesë mund të mbështetemi).

Përpara Policisë dhe Prokurorit Publik dëshmitari ishte i qartë në deklarinimin kundër të të pandehurve, me rastin e procedurës që nuk kishte asgjë të bëj me të, por me vjedhjen e veturës së tij. Në veqanti, me 27.7.2008 ai tha:

- Se kishte patur një prishje të raporteve të tij me djemtë Bekimin dhe Farukun, që kulminoi me vjedhjen e veturës së tij nga ata, gjë që e nxiti atë t'i raportoj Policisë;
- se përpara vjedhjes që ndodhi djali i tij Bekimi i kishte thënë atij se diku në vitin 2000 apo 2001, ai – së bashku me vëllaun e tij Farukun – kishte angazhuar një taksist nga Peja; kur ata arritën në një kodër të Cerovikut afër Klinës dhe kur taksisti kërkoi paratë për vozitjen, ata filluan të zihen dhe përlëshen, duke shkaktuar përfundimisht vrasjen e taksistit dhe duke marrë veturën e tij (një Opel Ascona e kuqe);
- se ai i tërhoqi vërejtjen djalit dhe ia ndaloi atij të mbaj Opel Asconën në shtëpi;
- se Bekimi, pas kësaj, e përdori veturën për së paku 5 muaj të tjerë.

Përpara Prokurorit Publik Sherif Zeka ofroi pjesërisht verzion tjetër të faktëve (lidhur me atë se kur iu rrëfue atij Bekimi lidhur me vrasjen). Ai deklaroi:

- se ai kishte marrur vesh për vrasjen vetëm dy vjet më heret (psh në 2006) nga bashkëfshatari i tij Gezim Gagiqi. Ky i fundit i tha atij se djali i tij Bekimi menjëherë pas luftës vrau një vozitës taksije nga Peja dhe morri nga ai veturën e tij;
- se mëpastaj ai e pyeti Bekimin nëse kjo ishte e vërtetë, dhe morri përgjigje negative.
- se më pas, më tepër se një vjet para se të merrej në pyetje nga Policia, një një person i panjohur shkoi tek shtëpia e Bekimit dhe e kapi gruan e Bekimit për flokë, duke i thënë se ai e dinte se kënd e kishte vrarë Bekimi pas luftës; andaj Sherif Zeka përsëri pyeti Bekimin për përfshirjen e tij në vrasje. Bekimi kësaj rradhe tha se menjëherë pas luftës ai dhe një vajzë (Teuta Hoti) *“morrën një taksist me Asconën e tij të kuqe, e dërguan në pyell të fshatit Cerovik, e plaqkitën atë dhe më pas e vranë dhe i morën veturën e tij”*.
- Ajo se çfarë i raportoi ai Policisë lidhur me përfshirjen e Farukut në vrasje Nuk ishte e vërtetë, pasi që Faruku në atë kohë ishte *“i sëmurë dhe nuk mund të bënte gjëra të tilla”*, pasi që ishte plagosur gjatë luftës;
- se ai nuk pranoi informata nga Bekimi lidhur me përfshirjen e mundshme të Arbenit;

- se ishte e vërtetë se Bekimi kishte në pronësi një Opel Ascona të kuq, menjëherë pas luftës;

Me rastin e shqyrtimit kryesor dëshmitari në mënyrë dramatike e ndryshoi verzionin në pikën kryesore. Ai tha se Bekimi asnjëherë nuk i kishte thënë se ai kishte vrapuar vozitësin e taksisë, dhe se kjo informata i ishte dhënë atij vetëm dy vjet më përpara nga shoku i tij Gezim Gagiqi. Ai konfirmoi, sidoqoftë, se pas luftës djali Bekimi kishte vozitur një "Opel Ascona" të kuq, për të cilin kishte thënë se e kishte blerë.

Dëshmitari ishte konfrontuar ashpër me deklaratat e bëra përpara Policisë dhe Prokurorit Publik, të cilat i janë kujtuar më lartë.

Ai nuk ishte i vullnetshëm/afte të ofroj një shpjegim për dy verzionet e ndryshme.

Trupi gjyqës vërejti se ai dëshironte shumë që të hjek fajin nga Arbeni, duke deklaruar se ai s'ka mundur të ketë kryer vrasjen sepse ai ishte "*gjithmonë së bashkume të*" ditën e natën.

Duke ardhur tek vlerësimi i deklaratave të Sherif Zekës, trupi gjyqës mendon se, përkundër kontradiktave të nënvizuara më lartë, sigurisht ekziston një pjesë e deklaratave të bëra gjatë hetimit të cilat meritojnë besimin.

Referenca bëhet këtu tek deklaratat fillestare, të cilat shkaktojnë fillimin e hetimit.

Ne veqanti, kurrfarë dyshimi nuk mund të ketë lidhur me faktin:

- se Bekim Zeka i tha Sherif Zekës se ai së bashku me dikënd tjetër (identiteti i i te cilit nuk mund të nxjerret nga deklaratat e Sherif Zekës, por i cili më vonë u bë i qartë nga deklaratat e dëshmitarëve tjerë) morri pjesë në vrasjen e taksistit nga Peja;
- se Bekim Zeka i tha Sherif Zekës se vrasja u bë "rreth vitit 2000", në afërsi të Fshatit Cerovik, sipas këtyre modaliteteve:
Kur vozitësi i taksisë arriti tek kodra e Cerovikut, afër Klinës, dhe kur vozitësi i taksisë kërkoi pagesën e vozitjes, filloi një përleshje, e cila përfundimisht rezultoi me vrasjen e taksistit dhe marrjen e veturës së tij.
- Se Bekim Zeka e pati për një kohë të caktuar pas luftës një Opel Ascona të Kuq (kjo rrethanë kurrë nuk ishte tërhequr.

Kështu që trupi gjyqës mendon se është e nevojshme të shpërfillet në tërësi tentimi për tërheqje gjatë shqyrtimit kryesor.

Dëshmia e vërtetësisë së këtij verzioni fillestar qëndron, derivon nga fakti se:

- ishte saktësisht falë këtyre fjalëve të Sherif Zekës që policia pati mundësi të përqëndrohet në hetimin e të pandehurve, të cilët (të bellafaquar me deklarata precize) më pas, pranuan praninë e tyre në krim (edhe pse ata tentuan t'i vëjnë fajin njëri tjetrit lidhur me atë se kush përfundimisht e rrahu dhe e vrau vozitësin e taksisë) dhe konfirmuan se modalitetet ishin saktësisht ato të treguara nga Sherif Zeka;
- Edhe Teuta Hoti konfirmoi rrethanat e treguara nga Sherif Zeka poashtu;
- Deklarata e Sherif Zekës sa i përket rrëfimit të Bekimit ka një shkallë të mirë të precizitetit dhe të detajeve dhe gjeti verifikimin e përpiktë në realitet: ajo saktësisht iu referua vendit ku ndodhi vrasja, modaliteteve të saj dhe "hapave" dhe (edhe pse me një shkallë më të vogël të përpikërisë) kohës së kryerjes së ngjarjes, duke ofruar përshkrim të qartë të viktimës dhe të qëllimit të saktë të kryerësve: është e pamundur të besohet se një përshkrim i tillë preciz dhe i detajizuar ka mundur të ketë ndodhur vetëm rastësisht; ngajshëm, nuk është e mundur të besohet se Sherif Zeka ka mundur të ketë marrur nga persona të tretë përshkrimin e saktë dhe modalitetet e agresionit;
- Me rastin e marrjes në pyetje edhe përpara Policisë edhe përpara Prokurorit Publik dëshmitari konfirmoi që ka marrë rrëfimin nga Bekimi (edhe pse përpara Prokurorit Publik një bellafaqim ishte i nevojshëm për të rifreskuar memorjen e

Shefi Zekës për atë). Ndryshimi i papritur dhe totalisht i pashpjegueshëm që ndodhi përpara trupit gjykues mund të gjen shpjegim në të menduarit e vështirësisë për t'i akuzuar djemtë në prani të tyre (dhe pas vizitimit të tyre disa herë në burg) dhe në kalimin e kohës në mes të vjedhjes së veturës dhe shqyrtimit kryesor (që e bën të kuptueshme se gjatë kësaj kohe dëshmitari ka mundur t'i rikonsideroj pasojat serioze të deklaratave të tij kundër djemve).

Kontradiktat në deklaratat e Sherif Zekës lidhur me person/in-at që ishte/ishin me Bekimin (përpara Policisë ai deklaroi se ishte Faruku, përpara Prokurorit Publik ai deklaroi se ishte Teuta Hoti) e bën të pamundur që nga ato deklaratat të nxjerret një përfundim i besueshëm sa i përket identitetit të tyre. Mund të konfirmohet, megjithatë, se Sherif Zeka është i qartë lidhur me faktin se Bekimi nuk ishte vet kur e kreu krimin.

Sherif Zeka me rastin e marrjes së tij në pyetje përpara trupit gjykues u përpoq me insistim të madh që të shfaqësoj djalin e tij Arbenin, duke tentuar t'i ofroj alibi atij.

Kjo përpjekje doli të jetë e paaftë, marrë parasysht mos-kredibilitetin e saj evident.

Dëshmitari në fakt, pas pranimit se ai nuk ka idenë për vitin, ditën dhe orën në të cilën krimi nishte kryer, megjithatë deklaroi se ai ishte së bashku me Arbenin në momentin e krimit, pasi që ata gjithmonë ishin bashkë, edhe "ditën edhe natën".

Jologjikshmëria e deklaratës së tillë mund të gjej shpjegim vetëm duke pranuar përpjekjen dëshpëruese të babës për të shpëtuar djalin. Ky synim i Sherif Zekës është bërë më evident poashtu nga fakti se ai është plotësisht kontradiktor sa i përket marrëdhënies me Bekimin dhe djemtë e tjerë: përpara Trupit gjykues ai tentoi të thotë se marrëdhëniet janë të mira me të gjithë, por menjëherë pas pas deklarimit të kësaj ai tha se djemtë e vodhën veturën, dhe prandaj ai e ka përzënë djalin nga shtëpia (lidhur me këtë shih poashtu deklaratat e Faruk Zekës).

Marrëdhënia (dhe integrimi dypalësh) i deklaratave të Sherif Zekës me pjesët tjera të provave do të sqarohet më poshtë.

3.2 Teuta Hoti

Deklaratat e Teuta Hotit janë të rëndësishme kryesore për këtë gjykim.

Përfshierja e saj personale në ngjarjet e Qershorit 1999 dhe mosperputhshmëritë e pjeseshme që dalin në pah kur kontrollohen deklaratat e saj të ndryshme imponojnë kujdesin më të madh në vlerësimin e tyre.

Ajo ishte marrë në pyetje nga policia me 28 Korrik 2008 dhe nga Prokurori Publik me 1 Gusht 2008 dhe me 15 Tetor 2008.

Trupi gjykues e morri në pyetje atë gjatë ndëgjimit të datës 15 Qershor 2009.

Gjatë marrjes në pyetje gjatë gjykimit dëshmitarja shumë herë u bellafaua me pjesët relevante të deklaratave të mëhershme. Ajo në mënyrë të përsëritur konfirmoi se deklaratat e dhëna përpara hetuesve ishin më të saktat. Për këtë arsye dhe për hir të tërësisë, marrë parasysht rëndësinë e dëshmisë së saj, është e përshtatshme të përmbledhen këtu të gjitha deklaratat e bëra nga dëshmitari përpara Policisë, Zyrës së Prokurorit Publik dhe trupit gjykues, duke patur gjithmonë ndërmend rregullën themelore për vlerësimin e provave siq parashihet me nenin 367 KPPK, sipas të cilit përmbajtja e deklaratave gjatë fazës hetuese mund të përdoret si provë për masën sa është mbrojtja në pozicion t'i sfidoj (kundërshtoj) ato.

Përpara Policisë Teuta Hoti deklaroi:

- se pas fundit të luftës në Kosovë ajo u zhvendos nga Prishtina në Pejë, ku filloi të jetoj së bashku me Bekim Zekën;
- Diku nga Korriku- Gushti 1999 Bekim Zeka dhe Arben Zeka, folën se e kishin verëjtur një person Serb apo Rom dhe për marrjen e veturës së tij;

- Një ditë, në ekzekutimin e kësaj ideje, Bekimi i tha Teutës të vesh uniformën e saj të UÇK-së dhe që t'a paraqes vehten tek një vozitës taksije si eprore e tyre. Ata shkuan në stacionin hekurudhor të Pejës, ku i vërejtën dy taksi, një Askonë të kuqe dhe një Golf të kuq.
- Bekimi apo Arbeni(dëshmitarja nuk ishte e qartë për këtë) propozoi që t'a marrin askonën, pasi që vozitësi i taksisë ishte një rom. Kështu që ata iu afruan taksistit dhe u pajtuan për një vozitje deri në fshatin Obri për Dhjetë Marka Gjermane;
- Ajo u ul në karrigën e përparme, të pandehurit prapa. Ajo kishte të veshur uniformën e UÇK-së, Arbeni mbante pantallona ushtarake dhe një këmishë të thjeshtë dhe Bekimi ishte në rroba civile⁴. Dëshmitarja, në veqanti , kishte të veshur uniformën e Bekimit dhe një palë sandale.
- pas fshatit Kijevë ata e morren rrugën dytësore për në fshatin Cerovik. Kur taksija arriti në një përpjetëz të ngushtë të rrugës së tillë, Arbeni e kapi për fyti vozitësin e taksisë nga prapa, gjersa Bekimi filloi ta grushtoj atë në gjoks dhe kokë;
- Në këtë pikë taksisti ndaloi veturën dhe Bekimi doli jashtë, derisa Arbeni e Kapte viktimën(që po bërtiste) për gjoksi;
- më pas të dy të pandehurit e tërhoqën zvarrë viktimën jashtë veturës, duke e grushtuar, shqelmuar dhe duke i thënë se donin t'a mbysin. Ndërkohë Teuta Hoti doli jashtë veturës dhe u largua rreth nja 20 metra larg nga frika. Nga atje ajo ende mund t'a ndëgjonte viktimën duke bërtitur dhe të pandehurit duke e rrahur atë;
- Njëzet minuta më vonë ajo i ndëgjoi dy të shtëna dhe mëpastaj zërin e Bekimit duke thënë: “ *hadje se e vramë atë, na ndihmo të shtyejmë veturën pasi që nuk po ndezet*”. Ajo u kthye tek vendi i krimit dhe e gjeti Bekimin brenda veturës; ajo dhe Arbeni e shtynë veturën derisa ajo u ndez;
- Ajo doli në karrigën e përparme derisa Arbeni ishte ulur në karrigën prapa. Ai tha se ata i morren portofolin vozitësit të taksisë dhe se aty nuk kishte para, vetëm dokumente dhe fotografi, gjë të cilën dëshmitarja mundi t'a shoh drejtpërdrejt;
- Mëpastaj ata u nisën në drejtim të fshatit Obri, ku mbërritën kur gati se u bë terr. Aty ata shkuan në shtëpinë e Dritonit (një kusheri i Zekajve), ku e kaluan natën në tri dhoma të ndara;
- Mbrëmjen e ardhshme ata shkuan në Pejë tek familja e Bekimit dhe derisa ajo qëndroi aty Bekimi nuk foli me prindërit e tij për rastin. Teuta Hoti foli për këtë me babanë e tij vetëm dy vite më pas;
- Bekimi ishte personi që e mbante armën.

Dëshmitarja përsëriti deklaratën e njëjtë kur ishte intervistuar nga Prokurori Publik gjatë hetimeve, me disa ndryshime/shtesa të vogla, të cilat i kujtojmë më poshtë:

- dëshmitarja tha se plani i Zekajve nuk ishte vetëm që t'a marrin veturën e taksistit Serb/Rom, por që poashtu t'a ekzekutojnë atë, dhe se ajo ishte në dijeni të atij;
- ajo tha se veshja e uniformës ushtarake të Bekimit nga ana e saj synonte enkas që të bind vozitësin e taksisë më lehtë;
- të dy vëllezërit i folën me vozitësin e taksisë tek stacioni hekurudhor i Pejës që te bien në ujdi për vozitjen;
- pasi që të shtënat ishin shkrepur, Teuta Hoti e pa armën tek Bekimi. Ajo ishte e zezë;
- një javë pas krimit (dhe jo mbrëmjen e njëjtë, siç deklaroi Bekimi në Zyrën e Prokurorit Publik) ata shkuan tek daja i Bekimit Ganiu;
- Opel Askona e kuqe ishte vozitur nga ata rreth Pejës pas vrasjes.

Prokurori Publik e morri në pyetje dëshmitarën me 15 Tetor 2009.

⁴ Dëshmitarja lidhur me këtë e përmirësoi vehten në fund të intervistës së saj, kur marrësit në pyetje e prekën në mënyrë më specifike çështjen e trobave të grupit.

Me këtë rast ajo u bellafaqua me deklaratat e bëra nga të pandehurit.

Ajo i vërtetoi deklaratat e saja të mëhershme duke shtuar si vijon:

- Të dy të pandehurit ishin përgjegjës për vrasjen: Bekimi sipas saj ishte “më tepër përgjegjës” pasi që ai e mbante armën, por poashtu edhe Arbeni ishte përgjegjës sepse ai e kishte “rrahur taksistin gjatë tërë kohës”;
- Bekimi vet i kishte thënë asaj “unë e vrava atë”;
- Pasi hyrën në veturë pas vrasjes Arbeni mbante në duart e tij dokumentet e të vdekurit e mëpastaj i dha portofolin Bekimit; Që të dy i kontrolluan dokumentet.

Teuta Hoti ishte marrur në pyetje në mënyrë të gjërë nga trupi gjykues në seancën ndëgjimore të 15 Tetorit 2009. Të gjitha rrethanat që dilnin nga marrjet në pyetje të mëhershme ishin diskutuar. Marrja në pyetje doli të jetë veqanërisht e vështirë, në sajë të gjendjes së pasigurtë emocionale të dëshmitarës dhe nevojës (së pretenduar) të saj për përkujdesje dhe humbje të memorjes pas një operimi që kishte pasur një muaj para seancës ndëgjimore. Gjatë marrjes në pyetje, pas specifikimit se në kohën e ngjarjes ajo kishte vetëm 15 vjet, ajo konfirmoi thelbin e deklaratave të dhëna më heret.

Në veqanti ajo vërtetoi:

- se ajo kishte takuar Zekajt 10 vjet më heret, duke qenë femra e Bekimit për një muaj e gjysmë;
- se në datën e ngjarjes ajo shkoi në stacionin e trenit me që të dy të pandehurit. Ata i thanë asaj të vesh uniformën ushtarake të Bekimit dhe të sillet si ushtarake, me qëllim që të gjejnë një taksist (qoftë Serb apo Rom) me qëllim që t’ia marrin veturën dhe t’a vrasin atë. Arbeni poashtu mbante pantallona pjesë të uniformës;
- Ata e gjetën një taksist të përshtatshëm që pranoi t’i transportoj ata. Teuta Hoti u ul në karrigën e përparmë dhe të pandehurit në karrigët prapa;
- Se pasi arritën në rrugën që hyn në Cerovik, të rrethuar nga pyje Arbeni e kapi viktimën për fyti, pastaj të dy të pandehurit filluan t’a rrahin atë dhe t’a tërheqin zvarrë në drejtim të pyllit. Në veqanti:
 - o Gjersa Arbeni e kapte viktimën për fyti, Bekimi (gjersa ishte ende në veturë) filloi t’a rrah viktimën;
 - o Mëpastaj të pandehurit e detyruan viktimën të dalë jashtë veturës, derisa rrahja po vazhdonte; Në këtë pike Teuta Hoti iku në drejtim përpjetë, e frikësuar, duke arritur në një distance prej 20 metrash nga vendi i krimit;
 - o Të dy të pandehurit e tërhoqën zvarrë viktimën në drejtim të pyllit.⁵
 - o Rrahja vazhdoi për rreth 20 minuta para se të shtënat të shkrepeshin⁶
- Atë e thirri Bekimi që të vinte prapa për t’i ndihmuar që të ndezte veturën e viktimës: ajo i ndihmoi të pandehurit që t’a shtyejnë veturën;
- Ajo e pa se të pandehurit kishin marrë portofoline viktimës dhe e kontrollonin atë, por nuk gjetën para brenda në të;
- Pas vrasjes, që të tre shkuan në fshatin Abri, tek shtëpia e Driton Avdiut (kusheri i të pandehurve) dhe atje e kaluan natën;
- Ajo e kishte parë armën edhe para ditës kritike dhe ajo e dinte se arma ishte në posedim të Bekimit.

Duket evidente se disa veqanti ishin shtuar nga Teuta Hoti para trupit gjykues, në krahasim me marrjet e mëhershme në pyetje. Në veqanti:

- Ishte Bekimi ai që morri iniciativën që t’a vras dikënd (“ai na tha: “t’a gjejmë dikënd që t’a vrajme”)⁷

⁵ Dëshimtarja ishte në gjendje të kujtoj se të dy të pandehurit ishin të përfshirë në tërheqjen zvarrë vetëm pas bellafaqimit me deklaratat e saja të mëparshme.

⁶ Dëshimtarja ishte në gjendje të kujtoj këtë rrethanë vetëm pas bellafaqimit me deklaratat e saja të mëparshme.

⁷ Shih procesverbalin e datës 15.6.2009, faqe 18.

- Në vijim të kësaj ideje ai dhe Arbeni mëpastaj arritën një marrëveshje⁸
- Derisa e zvarritnin viktimën në drejtim të pyellit të pandehurit e fyen atë dhe i thanë “ *ne duam të vrasim*”.

Këto shtesa nuk janë në kontradiktë me deklaratat e mëhershme.

Disa mospërputhshmëri dolën në pah me deklaratat e bëra më heret.

Në veqanti:

- Përpara trupit gjykues Teuta Hoti deklaroi se te dytë Arbeni dhe Bekimi i thanë a Asaj që të vesh uniforme ushtarake (ndërsa përpara Prokurorit Publik ajo tha se vetëm Bekimi i kishte thënë). Duhet të shtohet se, edhe pse, se pas bellafaqimit me deklaratat e saja të mëhershme, dëshmitarja në mënyrë të përsëritur deklaroi se ajo qëndronte në mënyrë integrale pranë saj, duke përmendur problemet me kujtësë dhe me stres.
- ajo deklaroi, lidhur me rrahjen brenda dhe jashte vetures, se “*Bekimi e kapi per fyti dhe e nxorri jashte vetures. Me pastaj te dyte ata e terhoqen zvarre ne pyll derisa edhe e rrahnin. Atehere une ika perpjete dhe pas pak degjova te shtenat. Menjeher pasi qe me thirren te kthehem atje: ata donin te ndeznin veturen por ajo nuk ndizej, pra kishte nevojte te shtyhej vetura... ata me thane çdo gje ishte kryer dhe me thane te shtyhej veturen*”⁹

Me rastin e marrjes ne pyetje nga trupi gjykues, dëshmitarja nganjehere provoi te terhiqet nga disa nga deklaratat e saja te mehershme te cilat tregonin perfshirjen e saj te mundshme ne sjelljen kriminale te te pandehurve.

Ne veqanti:

- Çeshtja nese Teuta Hoti, ne kohën e angazhimit te taksise, ishte e vetedijshme per qellimin e te pandehurve qe te vrasin (perpara trupit gjykues dëshmitarja ne disa raste pranoi te kete qene e vetedijshme per te; ne disa raste tjera ajo ne menyre te pergjithshme tha se “*nuk dinte asgje*” apo se “*ajo ishte vetem nje vajze(e re)*” ne kohën e krimit)
- Çeshtja nese ajo ishte detyruar (dhe nga kush) te veshe uniformen e UÇK-se me qellim qe te krijoje nje efekt me bindes tek vozitsi i taksise: me rastin e marrjes ne pyetje perpara trupit gjykues, ne fakt, Teuta Hoti deklaroi se te pandehurit e detyruan ate te veshte uniformen (dhe duhet te shtohet se dëshmitarja duke permirsuar vehten duke iu referuar deklaratave te bera me heret tek Prokurori Publik perfundimisht konkludoi se ai qe e detyroi ate te veshte uniformen ishte vetem Bekimi)

Duke ardhur te vlerësimi i dëshmisë së Teuta Hotit, kjo si në vijim mund të thuhet:

- Dëshmitarja u paraqit të jetë në shqetsim dhe hutim të madh gjatë shqyrtimit kryesor. Sipas mendimit të trupit gjykues, prania e drejtëpërdrejtë e të pandehurve, njëri nga të cilët ka qenë partner i saj gjersa ajo ishte 15 vjeqe ishte arsye e qartë për këtë;
- Dëshmitarja pranoi (poashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor, përkundër disa tentimeve kontradiktore për të tërhjekur këtë), se në kohën e ngjarjeve ajo ishte e vetëdijshme për synimet e të pandehurve për të vrarë viktimën, dhe që mos të kufizohen vetëm në vjedhjen e veturës së tij.

Sjellja e tillë e dëshmitarës duhet të konsiderohet si një indikator i mirë i besueshmërisë, sepse duke pranuar dijeninë e saj për synimet e të pandehurit dhe

⁸ Shih procesverbalin e datës 15.6.2009, faqe 19

⁹ Mbrojtësi I Bekim Zekes e ballafaqoi dëshmitarën me deklaratat e mëhershme (ku ajo tha se ishte Arbeni ai qe se pari e kapi viktimën per fyti). Dëshmitarja ne menyre te perseritur tha se ajo qendronte prane deklaratave qe kishte bere ne tri rastet e mehershme, duke theksuar stresin e saj aktual dhe problemet me kujtese dhe duke shtuar se ajo ndihej e kercenuar. E njejta vlene edhe per ate se kush I tha asaj, pas te shtenave, “*se çdo gje ishte kryer*”. Përpara trupit gjykues ajo shtoi se te dy te pandehurit I thane ashtu, ndersa perpara Prokurorit Publik ajo shtoi se vetem Bekimi I kishte thene ashtu. Perseri duke iu referuar problemeve te saja aktuale me kujtese dëshmitarja iu referua deklaratave te dhena perpara Prokurorit Publik si me te saktat.

kontributin e saj në veprimin e tyre ajo ka mund ta eskpोज vehten ndaj ndjekjes penale: Teuta Hoti, në fakt, nuk ka provuar të shmang pjesën e vet të përgjegjësive duke tentuar t'ua hudh fajin pjesmarrësve tjerë. Duhet të vërehet, se, në të kundërtën, se kjo ishte saktësisht sjellja e dy të pandehurve, të cilët kryekput e mohuan kryerjen e çfarëdo akti të relevenacës penale (secili nga ata duke mohuar të kishin pasur thjeshtë synimin për të vjedhur veturën e Ejup Broqi-t).

- Mbrojtja nuk ishte në gjendje të ngrit dyshime të arsyeshme sa i përket Besueshmërisë së Teuta Hoti-t. Në veqanti, të pandehurit e kufizuan vehten vetëm duke thënë se Teuta Hoti kishte për qëllim vetëm që të hakmirrej kundër tyre pasi që ishte joshur dhe lënë nga Bekimi. Kjo mbrojtje nuk është bindëse. Në fakt:

- o Teuta Hoti dëshmoi dhjetë vjet pas fundit të marrëdhënies së saj me Bekim Zekën, pasi që ishte martuar me person tjetër dhe ishte bërë Nënë e një fëmije. Është e rëndësishme të vërehet se ajo nuk ishte e vullnetshme të dëshmoj, dhe ishte ftuar vetëm për shkak se emri i saj ishte përmendur nga të tjerët të cilët dëshmuan përpara asaj. Andaj, asgjë, nuk tregon ekzistencën e lakmisë së saj për t'u hakmarrur kundër të pandehurve;
- o Ajo poashtu foli kundër vehtes, duke pranuar (përpara Zyrës së Prokurorit Publik dhe, nganjëherë, poashtu para trupit gjykues) se derisa ishte duke i ndihmuar të pandehurit të gjejnë një taksì, ajo e dinte synimin e tyre që t'a vrisnin vozitësin e taksisë. Kjo është, si u sqarua më lartë, simptom i vërtetësisë, sepse e përjashton që Teuta i hudh fajin të pandehurve me qëllim që të shmang përgjegjësitë e saj;
- o Pjesa më e madhe e dëshmisë së saj ishte vërtetuar nga vet të pandehurit dhe nga dëshmitarët tjerë (shih elaborimin e mëtejme për këtë);
- o Poashtu duke pranuar synimin e Teuta Hotit për të akuzuar rrejshëm Bekimin për veprën e pranuar nga ai, nuk do të kishte arsye fare për atë që t'a përfshiej Arbenin në komplot. Arben Zeka, personalisht, kur u pyet, për marrëdhënien e vet me Teutën, nuk ishte në gjendje të tregoj ndonjë arsye armiqësore me Teutën, dhe në të kundërtën, deklarata qartë se ai nuk pati probleme me të madje edhe kur ajo jetonte më familjen e tij.

- Trupi Gjykues mban tregimin e dëshmitarës si përnjëmend koherent, përkundër kontradiktave të vogla që janë nënvizuar më lartë. Teuta Hoti ofron një ekspozim të kënaqshëm të sekuencës së ngjarjes (dhe duhet të merret parasysht se dhjetë vjetë kanë kaluar nga koha e fakteve, duke pasur ndërmend poashtu që dëshmitarja, në atë kohë ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç e vjetër).

Tregimi i Teuta Hotit është shumë i detajizuar (në çfarëdo rasti më i detajizuar se tregimi nga Bekim dhe Arben Zeka): përkundër kësaj sasi të detajeve, deklaratat e Teuta Hotit nuk përmbajnë mospërputhshmëri përgjatë disa marrjeve në pyetje nëpër të cilat ajo kaloi. Në të kundërtën, trupi gjykues nuk mundi të ndihmoj pos të shënoj mospërputhshmëritë që ekzistojnë në mes deklaratave të dhëna nga Bekim dhe Arben Zeka gjatë ndëgjimit të 18 qershorit 2009 dhe deklaratave të dhëna në marrjet në pyetje të mëhershme.

- Veç faktit, tanimë të nënvizuar, se në kohën e ngjarjeve dëshmitarja ishte vetëm 15 vjeçe dhe se ngjarjet ndodhën dhjetë vjet më heret, kjo në vijim duhet të merret parasysht:

Së pari, duhet të theksohet se dëshmitarja, e bellafaquar me deklaratat e mëhershme, gjithmonë i zgjidhi mospërputhshmëritë duke deklaruar se verzioni korrekt ishte ai të cilin ajo e dha përpara Prokurorit Publik, duke përmendur gjendjen e saj personale të shqetësimit dhe hutimit.

Së dyti, këto mospërputhshmëri të vogla nuk i referohen thelbit të deklaratave të Teuta Hotit, të cilat mbesin solide sa i përket faktit se:

- që të dy, Arbeni dhe Bekimi ishin të përfshirë që nga faza planifikuese;
- që të dy ata morrën pjesë në rrahjen e viktimës;
- që të dytë ishin të pranishëm në momentin e të shtënit dhe të dytë u sollën në mënyrën që mbarte relevancë shkakore për kryerjen e veprës penale (në fakt: të dytë e rrahën viktimën përpara ekzekutimit, që të dytë e tërhoqën zvarrë atë drejt vendit të ekzekutimit deri sa u shkrepën plumbat).
- deklaratat e Teuta Hotit ishin vërtetuar nga disa elemente të jashtëm të tërësisë së provave. Në veqanti:
 - trupi i taksistit ishte gjetur në vendin e saktë që ishte përshkruar nga dëshmitarja (pylli jashtë fshatit të Cerovikut). Gjurmet e trupit tregojnë se ai ishte vrarë. Ai ishte një person me lëkurë të zeze, i cili lehtë mund të merret për Rom: kjo plotësisht përputhet me tregimin e ofruar nga Teuta Hoti;
 - e njejta vlen edhe për përshkrimin e veturës, që ishte përshkruar saktësisht nga ajo;
 - Dëshmitarët Arif Arifaj dhe Qerim Camaj, të cilët ishin tek stacioni i trenit në ditën kritike, konfirmuan se të pandehurit iu afruan një taksisë së bashku (poashtu edhe me Teutën) në afërsi të stacionit të trenit të Pejës. Kjo është në linjë me verzionin e Teuta Hotit dhe kundër verzionit të të pandehurve. Duhet të theksohet se lidhur me besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve nuk është e mundshme të ngrehen dyshime, pasi që:
 - ata nuk kanë lidhje me palët;
 - ata ishin dëshmitarë në vitin 2003, kur emrat e të pandehurve madje nuk ishin as të njohur;
 - Dëshmitarët e njejtë e vërtetuan verzionin e Teuta Hotit sa i përket rrobave që ajo mbante (dhe kundër verzionit të dëshmitarëve). Kjo është domethënëse poashtu sa i përket rrethanës (raportuar nga Teuta Hoti të pandehurit) se ekzistonte një plan që të përdoret Teuta Hoti si mjet për të bindur taksistin që t'i transportoj ata;
 - Të pandehurit personalisht konfirmuan substancialisht në pjesë të madhe deklaratat e Teuta Hotit. Në veqanti, të dy ata vërtetuan se:
 - në ditën kritike ata ishin së bashku në taksinë e Ejup Broqi-t. Të cilin ata e
 - angazhuan tek stacioni i Pejës;
 - se pasi që arritën në afërsi të Cerovikut, ngjau një përleshje me taksistin.
 - se në fund të rrahjes së tillë dy të shtëna ishin ndëgjuar;
 - se më pas Opel Askona e kuqe ishte marrur dhe drejtuar nga Bekimi.
 - se njëri nga ata e vrau Ejup Broqin duke shtënë në të;
 - se arma ishte revole.

Në mënyrë të rëndësishme, Arben Zeka personalisht, që ishte treguar nga Teuta si pjesëmarrësi i dytë në vepër, qartë pranon praninë e tij në ditën kritike;

- I pandehuri Bekim Zeka poashtu konfirmoi faktin (e përshkruar nga Teuta Hoti) se gjatë rrahjes së vozitësit të taksisë ajo u largua nga vendi i krimit.

Disa nga deklaratat e Teuta Hotit nuk përputhen me deklaratat e dëshmitarëve tjerë mbi rrethanat e njejta. Në veqanti, ajo deklaroi se pas vrasjes, ajo, Arbeni dhe Bekimi shkuan në fshatin Obri, ku ata e kaluan natën tek shtëpia e Driton Avdiut. Kjo rrethanë ishte mohuar nga Driton Avdiu, i cili plotësisht e mohoi se të tretë (apo disa nga ata) e vizituan shtëpinë e tij në Abri. Duhet, të theksohet, lidhur me këtë:

- se i pandehuri Arben Zeka konfirmoi se së paku ai personalisht kaloi natën tek shtëpia e Driton Avdiut (duke e diskredituar kështu besueshmërinë e Driton Avdiut);

- Driton Avdiu pati motiv të qartë që të mos tregoj të vërtetën lidhur me mikpritjen e tij të të pandehurve pas vrasjes, në mënyrë që mos ta mban trupi gjykues apo hetuesi atë si bashkëfajtor; çështja do të hulumtohet në mënyrë më detaje më poshtë;
- Rrethana, në çfarëdo rasti , nuk i referohet thelbit të sjelljes kriminale të të pandehurve. Andaj, korniza e paqartë e tërësisë së provave sa i përket vendndodhjes së saktë të të pandehurve dhe të Teuta Hotit pas vrasjes nuk i zbërthen provat solide lidhur me aspektet – thelbësore.
- Pra madje edhe supozimi se Teuta Hoti kishte qëllimin që të akuzoj rrejshëm të pandehurit, nuk do të kishte nevojë për të të gënjej për një rrethanë të tillë anësore (para se gjithash, përfshierja e njerzve tjerë – të afërmëve të të pandehurve – të cilët kanë mundur ta diskreditojnë atë).

Përfundimisht, tanimë është theksuar se të pandehurit nuk pajtohen me verzionin e Teuta Hotit në mënyrë specifike vetëm sa i përket përfshierjes personale të secilit nga ata në agresion.

Kjo do të thotë (si u përmend tanimë) se të dy të pandehurit e ndajnë ri-konstruktimin e ngjarjeve të ofruar nga Teuta Hoti, duke e kufizuar vehten në tentimin e tërheqjes prapa vetëm lidhur me pjesën më fundore të tregimit të saj.

Mosbesueshmëria e tregimeve të dy të pandehurve do të vlerësohet më poshtë.

Në çfarëdo rasti, dhe në përfundim trupi gjykues mendon se mospërputhshmëritë dhe inkoherenat e vogla të përshkruara më lartë nuk janë aq domethënëse sa të privojnë nga besueshmëria tërë dëshminë e Teuta Hotit, e cila duhet të mendohet se meriton besimin.

Lidhjet e saj dhe integrimi dypalësh me elementet e tjerë vërtetues do të theksohet më tutje, më poshtë.

3.3 Faruk Zeka

Faruk Zeka ishte dëshmitari i ndëgjimit të 16.6.2009. Ai është vëllau i të dy të pandehurve. Në kohën e ngjarjes (vera e 1999) ai po këndellej nga një plagë serioze e luftës, për të cilën ai, pak kohe më heret, ishte i hospitalizuar në Shqipëri. Pasojat e plagës ishin evidente poashtu me rastin e marrjes në pyetje në shqyrtimin kryesor (dëshmitari ishte në gjendje të flas por me vështirësi të mëdha).

Deklaratat e Faruk Zekës mund të përmbledhen si vijon:

- Pas luftës ai jetoi së bashku me familjen e tij në Pejë.
- Vëllezërit erdhën në posedim të një Opel Askone , me ngjyrë të kuqe¹⁰. Faruk Zeka nuk ishte në gjendje të kujtoj se cili nga vëllezërit e solli veturën në shtëpi;
- Të pandehurit të pyetur nga babai për prejardhjen e veturës, së pari shpjeguan e se e kishin blerë atë, mëpastaj shpjeguan se ata e kishin marrur veturën nga një vozites Rom i taksisë, të cilin ata mëpastaj e vranë¹¹
- Në atë kohë, Teuta Hoti ishte duke jetuar në shtëpinë e Zekajve për një periudhë të shkurtë kohore;
- Opel Ascona ishte zakonisht e vozitur nga Bekim Zeka¹². Arbeni asnjëherë nuk ishte parë nga dëshmitari duke e vozitur veturën;

¹⁰ Ngjyra e veturës ishte mbajtur mend nga dëshmitari pas konfrontimit me deklaratat e dhëna paraprakisht gjatë hetimeve.

¹¹ Rrethana ishte deklaruar nga dëshmitari pas bellafaqimit me deklaratat e mëhershme të bëra përpara Prokurorit Publik. Në fakt , dëshmitari deklaroi në ndëgjimin e 16.6.2009 se ai plotësisht qëndronte praën deklaratës në vijim: “ Vëllezërit e mi Bekimi dhe Arbeni erdhën në shtëpi me një veturë Opel Ascona, me ngjyrë të kuqe dhe më pas babai Im i pyeti ata ‘ ku e morrët këtë veturë’. Përgjegjja e tyre ishte se ata kishin blerë atë dhe kur prindërit e mi insistuan, ata pranuan se e kishin marrë atë veturë nga një vozites taksije Rom. Ata e morrën atë dhe e dërguan në fshatin Cerovik dhe aty e vranë dhe e lanë në pyell dhe i morrën veturën”. Gjatë shqyrtimit kryesor ai pati disa ngurrime sa i përket asaj se cili nga të dytë i rrëfeu Shefi Zekës se ata kishin kryer vrasje. Pavarësisht nga personi i cili ia tha këto fjalë Sherif Zekës, në çfarëdo rasti është e qartë nga konteksti i deklaratave të Faruk Zekës se që të dy të pandehurit ishin referuar si personat e vrasjes.

¹² Rrethana ishte referuar nga dëshmitari pas konfrontimit me deklaratat e bëra përpara Zyrës së Prokurorit Publik.

- Një vjet e gjysmë para se rasti të raportohet , Faruk Zeka dhe Bekim Zeka u përzënë nga shtëpia familjare nga Sherif Zeka. Arsyeja ishte (në rastin e Faruk Zekës) se ai nuk mund të punonte dhe kjo vazhdimisht qonte në diskutime me babanë.

Deklaratat e Faruk Zekës mbajnë relevancë domethënëse për këtë rast.

Së pari, duhet të theksohet se ai sigurisht është personalisht i besueshëm: kurrfarë elementesh apo rrethanash nuk ishin paraqitur nga palët, të mjaftueshme për të diskredituar deklaratat e tij. Në veçanti, kurrfarë shenjash armiqësie apo urrejtjeje ndaj të pandehurve nuk dolën në pah gjatë shqyrtimit kryesor, e as ndonjë shenjë e pabesueshmërisë së dëshmitarit.

Trupi gjykues, në të kundërtën, kishte përshtypje të fortë për pavarësinë dhe besueshmërinë nga Faruk Zeka. Ai po dëshmonte kundër vëlleërve të tyre, dhe është me rëndësi të nënvizohet se ata asnjëherë madje as nuk tentuan të pretendojnë se ai kishte ndonjë motiv që t'i akuzoj rrejshëm ata.

Besueshmëria e tij personale duhet, andaj, te merret si e siguruar.

Dëshmitari ishte koneskuent bërë raportimin pa ngurrim të kujtimeve të tij, duke iu referuar (kur nevojitej) deklaratave të mëhershme të bëra gjatë fazës hetimore. Kjo posqërsisht është e vërtetë në lidhje me rrethanën kryesore të cilën e raportoi dëshmitari (psh. Faktin se ai i ndëgjoi vëllezërit e tij duke i thënë babait të tyre se ata kishin vrarë vozitësin e taksisë), që është e rëndësishme kryesore për gjykimin e këtij rasti;

Në mënyrë të rëndësishme, dëshmitari ofroi një tregim që është pa kontradikta të brendshme, mbi disa rrethana të lidhura me krimin të cilin dëshmitari ishte në gjendje t'a kujtoj.

Përfundimisht, përshkrimi i Faruk Zekës gjen vërtetim të jashtëm në disa elemente të tërësisë së provave që ishin marrur në dosjen e rastit, dhe që janë përshkruar më lartë dhe më poshtë: tanimë është përshkruar, në fakt, se si deklaratat e tij mjaftueshëm i përkojnë ngjarjen e dhënë nga Sherif Zeka dhe Teuta Hoti, dhe atyre u ofron vërtetim domethënës.

3.4 Qerim Canaj dhe Arif Arifaj

Verzioni i dhënë nga Teuta Hoti ka marrë një vërtetim të rëndësishëm nga deklaratat e dhëna nga këta dëshmitarë.

Ata u gjenden në Pejë tek stacioni i trenit kur të pandehurit iu afruan viktimës me qëllim që të kërkojnë nga ai vozitje me taksì.

Dëshmitarët konfirmuan se:

- Rrobat e tre pjesmarrësve (të pandehurve dhe Teuta Hoti personalisht) ishin ërshkruar njëjtë si nga përshkrimi i Teuta Hoti: ajo mbante uniformën ushtarake të UÇK-së, njëri nga dy vtëvtjerët mbante pantallona pjesë të uniformës ushtarake dhe një këmishë të çiltër ndërsa i treti mbante rroba të thjeshta.
- Të tretë ishin së bashku kur iu afruan vozitësit të taksisë.
- Viktima ishte personi i dytë të cilin ata e pyetën për vozitje, pasi që më parë e kishin pyetur për këtë një pronar të një veture Mercedes.

Trupi gjykues mendon se nuk mund të ketë dyshime sa i përket objektivitetit të dëshmitarëve.

Në të vërtetë:

- ata ishin marrur në pyetje prapa në vitin 2003, kur nuk patën kurrfare ideje për identitetin e të dyshuarve(kështu që është e pamundur që madje edhe të pretendohet se ata synojnë të akuzojnë dikënd rrejshëm).
- Ata nuk kane kurrfarë lidhjesh me familjen e të pandehurit apo me familjen e viktimave.

- Ata ofrojnë informata (lidhur me rrobat e të pandehurve dhe të Teuta Hoti-t) të cilat ishin konfirmuar në mënyrë të përpiktë nga kjo e fundit.

3.5 Driton Avdiu

Ky dëshmitar i ofroi gjykatës elementet anësore që të cilat përmbajnë një relevancë të caktuar për gjykimin e rastit.

Në fakt, Driton Avdiu i vertëtoi gjykatës se pasi që vozitësi i taksisë ishte vrarë, ai pati rastin disa herë t'i vërej të pandehurit duke e vozitur Opel Askonën ngjyrë të kuqe të mbyllur.

Ai shtoi se dy-tri ditë përpara vrasjes, fshatarët filluan të thojnë se fajtorët ishin Bekim dhe Arben Zeka.

Në anën tjetër, dëshmitari nuk i konfirmoi deklaratat e Teuta Hotit, sipas të cilave:

- Dritoni ishte kushëriri i të pandehurve;
- Se pas vrasjes ajo, Arbeni dhe Bekimi mbërritën tek shtëpia e Dritonit dhe atje e kaluan natën.

Lidhur me besueshmërinë personale të Driton Avdiut, para se gjithash është më rëndësi të vërehet se me asnjë gjë të pandehurit nuk e pretenduan ekzistencën e motiveve që ata t'i akuzoj rrejshëm.

Lidhur me mospërputhshmëritë e treguara më lartë, sipas mendimit të trupit gjykues ato nuk mund të stërpotencohen në nivelin që të diskreditojnë dëshminë e Teuta Hotit në tërësi.

Para se gjithash, tanimë ishte nënvizuar më lartë se Arben Zeka personalisht i diskreditoi këto deklaratat të dyta, kur ai tha se ne mbrëmjen e vrasjes ai e kaloi natën tek shtëpia e Driton Avdiut. Ai poashtu shtoi se familja e Driton Avdiut kishte në pronësi edhe një banesë në Abri (në bodrum e cila ishte djegur gjatë kohës së luftës).

E dyta, duhet të theksohet edhe një herë se në kohën e ngjarjeve (që ndodhën 10 vjet më parë) Teuta Hoti ishte vetëm 15 vjeq në moshë. Ajo po jetonte me Bekim Zekën vetëm për një muaj – një muaj e gjysmë. Prandaj disa hutime lidhur me emrin apo vendin ku ajo kaloi natën pas vrasjes janë të pakuptimta.

E njëjta mund të thuhet vetëm në mënyrë shumë më të vështirë lidhur me faktet e "paharrueshme" të agresionit, rrahjen dhe vrasjen e Ejup Broqi-t (të cilat, për natyrën e tyre të dhunshme dhe brutale dhe për veqantitë e veta me gjasë do të lëjnë kujtime të fuqishme në kujtesën e një personi të ri).

Përfundimisht, tanimë ishte theksuar më lartë se Driton Avdiu pati interes të jep deklaratë të rrejshme në mënyrë specifike lidhur me këtë, pasi që mikrpritja e fajtorëve pas vrasjes mund në mënyrë teorike të mbart disa pasoja lidhur me të përfshirjen në procedurë penale.

3.6 Gani Morina

Gani Morina ishte dëshmitar i ndëgjimit të datës 18 qershor 2009.

Ai është daja i të pandehurve (ata janë fëmijët e motrës së tij).

Dëshmia e Gani Morinës përmban disa elemente të relevancës për këtë rast.

Sa i përket deklaratave të bëra nga Driton Avdiu, ekzistojnë disa mospërputhshmëri lidhur me deklaratat e mëhershme të bëra përpara Zyrës së Prokurorit Publik. Duhet të shtohet se dëshmitari, kur u bellafaua me kontradiktat në deklaratat e tij, nuk ishte në gjëndje të ofroj një shpjegim bindës (kjo në lidhje me, për shembull, çështjen nëse Bekim Zeka i kishte treguar atij për vrasjen e vozitësit të taksisë).

Më poshtë është një përmbledhje e deklaratave të tij gjatë shqyrtimit kryesor:

- Teuta Hoti sihte parë nga dëshmitari me Bekim Zekën rreth kohës kur vrasja Ndodhi;
- Në verë të vitit 1999, ai ndëgjoi për vrasjen e një vozitësi të taksisë në Cerovik;
- Bekimi i kishte thënë atij se ai kishte marrur një veturë nga një taksist në Cerovik;

Dëshmitari në mënyrë të thellë u konfrontua e deklaratat e tij të mëhereshmë të dhëna përpara zyres së prokurorit publik një vit më heret.

Vërtetë, përpara Prokurorit ai deklaroi se pas luftës, në vitin 1999, Bekimi i tha atij se ai e kishte vrarë dikënd dhe se ia kishte marrur edhe veturën atij. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitari në mënyrë të qartë tentoi të tërhiqet nga deklaratat e tilla: në veqanti, dëshmitari gjatë shqyrtimit kryesor pohoi:

- se që të dy deklaratat (ato të dhëna gjatë hetimit dhe ato të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor) ishin të vërteta, duke harruar në mënyrë kontradiktore mospërputhshmëritë tepër të mëdha në mes të deklaratave të përmendura më sipër;
- se ishte e verëtetë që Bekimi i kishte thënë atij se ai kishte vjedhur veturën e kuqe Opel Askona nga një taksist, por pastaj sapo e dëgjoi këtë, ai e parandaloi Bekimin nga tregimi i pjesës së mbetur të stories, sepse ishin të pranishëm djemtë e tij. Andaj ai nuk e ndëgjoi Bekimin duke i thënë se ai kishte vrarë një person dhe më pas kishte marrur veturën e tij;

Duke ardhur te vlerësimi i deklaratave të Gani Morinës , ne së pari duhet të marrim parasysh besueshmërinë e tij personale.

Të pandehurit asnjëherë nuk e sollën në pyetje atë, ata as që e potencuan ndonjë arsye të armiqësisë apo urrejtjes apo ndonjë interes që ai të thoshte gënjeshtër për ata.

Veç kësaj, marrëdhënia e tij e afërt me ata duhet të merret parasysh (ai ishte daja i tyre).

Andaj sipas mendimit të trupit gjykues një shkallë e mirë e besueshmërisë duhet t'i atribuohet deklaratave të tij të bëra kundër të pandehurve. Kjo vlen, për shembull, për faktin se Gani Morina deklaroi se Bekimi i tha atij se *"ai kishte marrë një veturë nga një taksist në Cerovik"*.

Lidhur me mospërputhshmëritë mes deklaratave të bëra nga Gani Morina gjatë shqyrtimit kryesor dhe atyre të bëra më heret, një gjë duhet të vlerësohet këtu. Kjo i përket asaj nëse ai kishte apo nuk kishte ndëgjuar Bekimin duke i thënë atij se ai kishte vrarë një person dhe ia kishte marrë veturën.

Trupi gjykues mendon se nuk është e besueshme, deri në këtë nivel, ajo që Gani Morina deklaroi gjatë shqyrtimit kryesor. Vërtetë:

- nëse do të kishte qenë e vërtetë, do të thoshte se Bekim Zeka ishte duke folur me të, Gani Morina ishte në gjendje të parathotë (apo sidoqoftë ishte në dijeni paraprakisht) se Bekim Zeka do t'i thonte disa nga rrethanat të cilat ishin aq serioze që nuk do të mund të ndëgjoheshin madje edhe nga një fëmijë. Kjo në mënyrë të qartë nuk ka kuptim, sespe deri më atëherë, sipas fjalëve të njejta të Gani Morinës, ai nuk kishte idenë se tregimi i Bekimit përmbante elemente të cilat nuk do të mund të ndëgjoheshin nga një fëmijë. Prandaj nuk kishte arsye për të që të parandaloj Bekimin në vazhdimin e shpjegimit të tij.
- Në mënyrë kundërthënëse, gjatë shqyrtimit kryesor Gani Morina konfirmoi deklaratën e tij (të dhënë gjatë hetimeve) sipas të cilës Bekim Zeka nuk i tha atij se ai ka kryer një vrasje *në bashkëfajësi me dikënd tjetër*. Kjo logjikisht nënkupton se Bekim Zeka duhet t'i ketë thënë atij se kishte kryer një vrasje.

Për këto arsye Trupi gjykues mendon se verzioni i fakteve të cilat mund të besohen është ai që Gani Morina e dha përpara hetuesve: duhet të merret parasysh si e dëshmuar, atëherë, se Bekim Zeka i tha Gani Morinës se ai e kishte vrarë taksistin pasi që ia kishte marrë veturën atij.

Ekzistojnë arsye të mjaftueshme të besohet se Gani Morina me dijëni bëri deklaratatë të rrejshme përpara trupit gjykues. Prokurori Publik andaj do të paiset me një kopje të deklaratave të tij, në mënyrë që atij t'i mundësohet të vazhdoj kundër dëshmitarit për veprën e dëhsmisë së rrejshme.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të vërehet, se gjatë shqyrtimit kryesor Gani Morina konfirmoi se Bekim Zeka i rrëfeu atij "marrjen e veturës" nga një person në Cerovik.

Kjo ofron vërtetim të fuqishëm të deklaratave të Teuta Hotit, Faruk dhe Sherif Zekës, dhe për më tepër, burimi është i besueshmërisë së veçantë, duke qenë se është daja(xhaxhai) i të pandehurit.

3.7 Mbrojtja e Bekim Zekës dhe Arben Zekës

3.7.1. Bekim Zeka

Bekim Zeka ishte marrur në pyetje dy herë nga Prokurori Publik. Gjatë shqyrtimit kryesor ai ishte marrur në pyetje me 18 qershor, 2009.

Më poshtë është një përmbledhje e deklaratave të tij të bëra gjatë shqyrtimit kryesor:

- pas luftës ai mbërriti tek familja e tij në Vitomicicë dhe jetoi me ata. Teuta Hoti qëndroi aty për një muaj-një muaj e gjysmë aty;
- në ditën kritike, pas urdhërit nga nëna e tij, ai e lëshoi shtëpinë me Teuta Hotin për t'i marrë motrat e tij tek shtëpia e Gani Morinës; 500 metra pasi që dolën nga shtëpia atyre iu bashkangjit, Arbeni;
- Të tre nuk patën sukses në kërkimin e taksistit të tyre të parë. Mëpastaj, Teuta dhe Bekimi vazhduan në këmbë, me qëllim që të presin Arbenin tek Pompa e benzinës "Ina". Ndërkohë Arbeni ishte duke kërkuar vozitje me taksi nga një taksist tjetër të cilin ai kinse e njihte.
- Taksisti dhe Arbeni arritën, Bekimi hyri në veturë për t'u ulur në karrigën e përparme, gjersa Arbeni dhe Teuta u ulën në ulëset prapa; Arbeni e angazhoi taksinë deri në Kijevë;
- Pasi arritën në Kijevë, Bekimi dontë të dal jashtë, por taksisti iu ofroi t'i dërgonte deri në Cerovik. Pasi arritën në Cerovik, Bekimi i tha Arbenit që t'a lejonte viktimën që të kthehet në Peja, por në atë moment, ashtu krejt papritmas, Arbeni e sulmoi viktimën, duke e fyer dhe grushtuar nga prapa;
- Vetura ndaloj dhe të dytë vazhduan jashtë të rrahen. Bekimi tentoi t'i ndaj ata duke iu goditur të dytë, por pa sukses¹³. Pastaj, duke parë se Teuta kishte ikur, ai vrapoi pas asaj. Kur ai ishte në distancë prej rreth 500 metrash, derisa po kalonte përpara shtëpisë së Bajram Mehmetit, ai dëgjoi dy të shtëna¹⁴. Ai mëpastaj vazhdoi deri tek shtëpia e Hadaki-t, e quajtur "Kulla", ku e pa taksinë duke ardhur. Arbeni po e voziste atë. Ai i urdheroi ata të hypin në veturë, por pasi që ai kishte dalur jashtë kontrollit Bekimi voziti në drejtim të shtëpisë së Ganiut¹⁵, pasi

¹³ Ekziston një kundërthënie gojëplotë në mes të verzionit të dhënë nga të pandehurit përpara trupit gjykues dhe verzionit të dhënë Policisë gjatë hetimeve. Ai deklaroi përpara policisë se "Taksisti e ndali veturën anash rrugës dhe e fyu(mallkoi) Arbenin. Pastaj menjëherë j të gjithë dolëm nga veturae atëherë unë fillova t'a fyej(mallkoj) taksistin, iu afrova atij dhe e grushtova në fytyrë taksistin dhe ai a në gjunjë në tokë dhe Arbeni poashtu e fyejti atë. Mëpastaj përsëri unë vazhdova ta grushtoj taksistin për nja tri-katër herë tjera. Ai u ngrit duke më fyer". Në këtë version dhënë policisë, deri në këtë moment Arbeni nuk e preku taksistin. Ndërsa ishte Bekimi që e goditi taksistin. I pandehuri nuk ishte në gjendje të ofroj një shpjegim për këtë mospërputhshmëri të rëndësishme.

¹⁴ Pas një konfrontimi të madh i pandehuri në mënë të përsëritur deklaroi se iu deshën 30 minuta të ecjes së shpejtë për të mbërrit tek shtëpia e Bajramit. Ai shtoi se ai u nis të largohet nga vendi i ngjarjes dhjetë minuta pasi që filloi rrahja në mes Arbenit dhe viktimës. Distanca kohore në mes të fillimit të rrahjes dhe përfundimit të saj përmbledhet në dyzet minuta.

¹⁵ Ekzistoi një kundërthënie domethënëse në mes të kësaj deklarate dhe asaj të bërë në Polici gjatë hetimeve. Në të vërtetë, përpara Policisë Bekimi deklaroi se vetëm ai dhe Teuta Hoti shkuan në këmbë tek shtëpia dajës Gani, dhe se Arbeni nuk erdhi me ata dhe se vetëm mëpastaj ai e gjeti Arbenin në shtëpinë e Driton AVdiut. I Pandehuri u bellafaqua me këtë, mirëpo nuk ishte në gjendje të zgjidh kundërthënien.

që ia kishte marrur Arbenit armën, e cila ishte në dysheme të veturës. Kjo ishte hera e parë që Bekimi e pa atë armë¹⁶;

- Bekimi i tha Ganiut : *“veç sa u dhie puna”*. Mëpastaj ai i morri motrat dhe dajën Gani dhe u kthye ne veturë në Vitomiricë, duke e lënë Teutën në Trstenik¹⁷.
- Pasi arritën në shtëpi , udhëtarët zbritën dhe ai menjëherë e dërgoi armën tek KFOR-i italian. Kur u kthye në shtëpi, Arbeni tanimë i kishte thënë familjes për vrasjen; Babai e urdhëroi Bekimin që mos të thoshte asgjë përreth;
- Dy ditë pas ngjarjeve, Bekimi përsëri i tha babait të tij se Arbeni kishte vrarë vozitësin e taksisë, në çfarë babai u përgjegj: *“ E di, nuk ka nevojë të që të ma shpjegosh atë”*¹⁸;
- Sipas mendimit të Bekimit e vetmja arsye për rrahjen ishte sasia e parave e kërkuar nga vozitësi i taksisë për vozitjen.

Disa kundërthënie dolën në pah nga deklaratat e Bekim Zekës. Këto kundërthënie (kundërthëniet e brendshme të deklaratave dhënë Trupit Gjykses dhe kundërthëniet me deklaratat dhënë Policisë) janë nënvizuar si duhet ne “footnotat” e mësipërme.

Besueshmëria e mbrojtjes së Bekim Zekës dhe pajtueshmëria e tyre me provat e mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor do të shpjegohet(kryhet) më poshtë.

3.7.2 Arben Zeka

Arben Zeka ishte marrur në pyetje gjatë ndëgjimit të datës 18 qershor 2009, pasi që ishte intervistuar dy herë gjatë hetimeve.

Më poshtë është një përmbledhje e deklaratave të tij të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor:

- Bekim Zeka dhe Teuta Hoti po dilnin bashkë në kohën kur ngjarjet ndodhën. Teuta Hoti për një kohë qëndroi tek shtëpia e Zekajve;
- Në ditën kritike Bekimi dhe Teuta u kthyen prej Prishtinës. Ai i takoi ata në shtëpi dhe pasi që pien kafe Bekimi dhe Teuta vendosën që të shkojnë në Prishtinë me taksi. Ai iu bashkangjiti atyre pasi që kishte nevojë të shkojë në Obri. Bekimi dhe Teuta e ngazhuan një taksi, derisa ky po rrinte në një distancë prej dhjetë metrash larg nga ata. Ata e angazhuan taksinë e parë të cilit iu afruan¹⁹
- Teuta mbante rroba civile²⁰
- Arbeni hyri në taksi dhe u ul prapa Bekimit, i cili ishte ulur në karrigën përpara;

¹⁶ Përpara Policisë I pandehuri deklaroi se ai edhe përpara ditës kritike e dinte se Arbeni posedonte një armë dhe se për atë arsye frikësohej nga ai. Kjo është në kundërthënie të qartë me atë që deklaroi përpara Trupit Gjykses dhe andaj Bekim Zeka ishte konfrontuar, por nuk ishte në gjendje të ofroj një shpjegim bindës për kundërthënien.

¹⁷ Një tjetër kundërthënie zhurmëmadhe paraqitet këtu me atë se çfarë I deklaroi Policisë në qershor 2008, kur Bekimi tha se pasi që mbërriti tek shtëpia e dajës Gani, daja Sylë shkoi të marrë nënën dhe babain e Bekimit dhe I sollu aty. Bekim Zeka u bellafaqua me këtë, por nuk ishte në gjendje të ofroj shpjegim bindës të kundërthënies. Veç kësaj, Bekim Zeka përsëri ranë kundërthënie me vehten lidhur me udhëtimin prapa në shtëpi. Para policisë ai, vërtetë, deklaroi se babai I tij ishte në veturë me të në rrugën e kthimit bpër ne Pejë dhe se në atë rast ai iu rrëfue babait: *“ E mbytem atë”*. Kur u bellafaqua me këtë gjatë shqyrtimit kryesor Bekimi së pari deklaroi se nuk ishte e vërtetë se Sherifi ishte me ata, menjëherë më pas ai e përmirësoi vehten duke thënë, se vërtetë, Arbeni vetëm kishte thënë se Arbeni e kishte vrarë taksistin personalisht , dhe përfundimisht Bekimi mbaroi duke thënë atij nuk mund t’i kujtohej asgjë lidhur me udhëtimin prapa.

¹⁸ I pandehuri në mënyrë të gjërë ishte bellafaquar me deklaratat e tij të mëhershme lidhur me këtë temë. Në fakt, përpara Policisë dhe Prokurorit Publik ai deklaroi se I tha prindërve të tij se Arbeni e kishte vrarë taksistin, duke shkaktuar kështu reagim të ashpër të babait të tij , i cili I mallkoi djemtë e tij. Gjatë shqyrtimit kryesor ne menyrë të përsëritur pretendoi se ishte Arbeni i cili I rrëfue babasë veprimin., ashtu që kur Bekimi hyri në shtëpi, të gjithë I dinin ngjarjet. Ky version I dhënë përpara trupit gjykses e bën të pakuptueshme se përse dy ditë më vonë Bekimi e ndjeu të nevojshme që t’I tregoj babait të tij se Arbeni e kishte vrarë taksistin. Është mendim I trupit gjykses se kjo kundërthënie është asgjë pos një rezultat I tentimit të ngathët të Bekimit që të harmonizoj atë me deklaratat e mëparshme(me rezultat që të krijoj një tjetër kundërthënie);

¹⁹ Kjo deklaratë e Arben Zekës është në kontradiktë të thellë jo vetëm me deklaratat e Teuta Hotit (dhe Bekim Zekës) , por poashtu edhe me dëshmitë e personave që ishin të pranishëm në stacionin e trenit ne ditën kritike, të cilët në mënyrë unanime thanë se, para hyrjes në taksinë e Ejup Broqit , që të tre provuan të angazhojnë një tjetër taksi. Kjo rrethanë është e sigurtë, sepse njëri nga dëshmitarët është përsosni të cilin ata tentuan ta angazhojnë përpara kontaktimit të Ejup Broqit.

²⁰ Rrethana është në dallim jo vetëm me atë çfarë tha Teuta Hoti , por poashtu edhe me deklaratat e personave që ishin të pranishëm tek stacioni I trenit në ditën kritike dhe I panë të tretë duke iu afruar taksistëve. Ata thonës e femra në grup (psh Teuta) po mbante uniformë ushtarake dhe njëri nga të tjerët pantallona ushtarake dhe një maicë.

- Para arritjes në Cerovik, Bekimi ndaloi veturën me frenin e dorës, nxorri qelësat dhe filloi ta rrah taksistin derisa ende ishin brenda në taksi²¹, pas kësaj ai doli jashtë, e kapi taksistin dhe e tërhoqi jashtë zvarrë, ku vazhdoi rrahja;
- Sapo që Bekimi filloi t'a grushtoj viktimën brenda në veturë, Arbeni i tha Bekimit: "Çfarë je duke bërë?", dhe pastaj u largua menjëherë nga vendi i krimit pa intervenuar në rrahje. Ai mundi të vërej se Teuta po largohej nga vendi i krimit në kohën e njejtë²².
- Arbeni nuk dinte kurrfarë arsye pse Bekimi e sulmoi taksistin; Arbeni provoi verbalisht që t'a ndal Bekimin para se të largohej. Ai ndëgjoi dy të shtëna kur ai ishte në hekurudhë, një distance dhjetë minuta ecje në këmbë nga vendi i krimit;
- Arbeni shkoi tek shtëpia e Driton Avdiut në Obri, ku e mbërritën Bekimi dhe Teuta. Bekimi aty i tha atij se e kishte vrarë një Rom. Ata pinë kafe dhe mëpastaj Bekimi dhe Teuta u larguan në drejtim të Gllobare-s me Askonën e kuqe. Tanimë ishte terr. Arbeni e kaloi natën në shtëpinë e Bajram Rexhës (që ishte gjyshi i Driton Avdiut), derisa Bekimi e Teuta shkuan tek shtëpia e Gani Morinës.
- Ditën e nesërme Arbeni u kyhye në Pejë me autobus. Ndërkohë Bekimi i kishte treguar babit të tij për ngjarjet dhe më pas i tha Arbenit se ai i kishte rrëfyer babait atë.

3.8 Vlerësimi i përbashkët i provave

Provat kundër të pandehurve janë koneskuente dhe në bazë të tyre është e mundshme të përfundohet përtej dyshimit të arsyeshem se ata e kanë vrarë Ejup Broqin.

Së pari, është e sigurtë se në ditën kritike të pandehurit e angazhuan viktimën për t'i dërguar ata me taksi nga Peja në Cerovik dhe andaj ata ishin me të në taksi deri kur ndodhi rrahja. Kjo rrethanë në mënyrë kuptimplote është pranuar nga të dy të pandehurit. Nga arsyeja e njejtë (pranimi i të pandehurve) është e sigurtë se në Cerovik, në fund të vozitjes, një rrahje e dhunshme shpërtheu me vozitësin e taksisë: një rrahje që përfundoi me vrarjen e viktimës.

Të pandehurit pohuan të jenë krejtësisht të pafajshëm, duke e akuzuar njëri tjetrin për sulm autonon mbi viktimën pa bashkëpunimin nga tjetri.

Në këtë mënyrë ata tentuan që në procedurë të sjellin elementin e pasigurisë sa i përket autorit të krimit. Kjo mbrojtje, edhe pse, është qartë kundërthënëse me provat dërmuese të cilat janë ilustruar më lartë.

Në fakt duke e përmbledhur përmbajtjen e tij, trupi gjykues mendon se:

1. Bekim Zeka i rrëfeu Sherif Zekës se ai, në bashkëfajësi me dikënd tjetër, e vrau vozitësin e taksisë dhe e vodhi veturën e tij; akuzimi fillestar se Sherif Zeka, siç u arsyetua më lartë (shih 3.1) lidhur me këtë është e besueshme. *Per se*, rrëfimi tanimë mban vlerë domethënëse dëshmuese.
2. Rrethana ishte vërtetuar nga Faruk Zeka, i cili deklaroi se ai kishte dëgjuar të pandehurit duke iu rrëfyer babait se ata kishin vjedhur një Opel Askona të kuq nga një vozitës taksije Rom, të cilin ata poashtu e vranë²³;

²¹ I pandehuri ishte bellafaquar me kundërthëniet ekzistuese në mes të këtyrë deklaratave dhe atyre të bëra përpara Zyrës së P. Publik me 10 tetor 2008. Përpara Prokurorit, në të vërtetë, ai deklaroi se ku taksisti arriti në Cerovik, Bekimi e urdhëroi taksistin që të ndal automjetin. Mëpastaj ai doli nga dera e prapme dhe e hapi derën e taksistin dhe e kapi atë për fyti. Kështu në verzionin e dhënë përpara Zyrës së Prok. Publik rrahja filloi vetëm kur Bekimi ishte jashtë taksisë, dhe ishte viktimë ai që e ndaloi taksinë (dhe jo Bekimi duke e ngrehur frenin e dorës). I bellafaquar me këto mospërputhshmëri, I pandehuri deklaroi se verzioni i saktë ishte ai që ai e tha përpara trupit gjykues.

²² Ishte një kundërthënie tjetër relevante lidhur me këtë pikë me deklaratat e bëra përpara Zyrës së Prok. Publik me 10 tetor 2008. Me atë rast Arbeni deklaroi se kur ai doli jashtë veturës, në atë moment Teuta, së bashku me Bekimin, filloi të rrah tani vozitësin vdekur. Përpara trupit gjykues, në të kundërtën, ai deklaroi se Teuta vetëm se doli nga vetura në kohën kur rrahja filloi dhe u largua nga vendi i krimit. I bellafaquar me këtë kundërthënie ai nuk ishte në gjendje t'a shpjegoj atë.

²³ Mbi deklaratat e Faruk Zekës, shih më lartë.

3. Deklaratat e Sherif dhe Faruk Zekës dhënë policisë janë vërtetuar nga deklaratat e Teuta Hotit, që ofrojnë detaje domethënëse(pasi që është dëshmitarë i drejtpërdrejt). Ia vlen të vërehet(si shenjë tutje e besueshmërisë) se dëshmitë e Zekajve dhe Teuta Hotit janë plotësisht të pavarura nga njëra tjetra. Në mënyrë të rëndësishme, Teuta Hoti i ofroi trupit gjykues identitetin e bashkefajtorit të Bekim Zekës(Arben Zeka, që më pas vërtetoi se ai ishte në veturë) dhe detajet e sakta të ngjarjeve në ditën kritike, që përforcojnë atë që i është thënë hetuesve nga të pandehurit.

Në veqanti:

- Të pandehurit patën qëllimin që t'a vrajnë taksistin dhe t'ia marrin veturën.
- Që të tretë shkuan së bashku tek stacioni i trenit me qëllim që të angazhojnë një taksi. Kjo ishte bërë edhe më e lehtë pasi që Teuta Hoti po mbante një uniformë ushtarake, të cilën të pandehurit e shtyen atë ta veshin;
- Pasi që arritën në Cerovik të pandehurit filluan t'a rrahin dhe grushtojnë viktimën, brenda dhe jashtë veturës.
- Bekim Zeka e kishte një pistoletë;
- Viktima ishte tërhjekur zvarrë nga të pandehurit në drejtim të pyellit në afrësi;
- Rreth nja njëzet minutash pasi që filloi rrahja, Teuta Hoti(e cila ndërkohë ishte larguar nga pamja, në një distancë rreth njëzet metra nga vendi i krimit) i ndërgjoi dy të shtëna. Ajo mëpastaj ishte thirrur të kthehet nga të pandehurit(apo vetëm nga Bekimi) , i cili i tha: “ *Kthehu, ka përfunduar tash,*” apo “*Kthehu, se e vramë atë*” .

4. Një vërtetim i mëtutjeshëm i besueshmërisë së verzionit të Teuta Hotit ,krahasuar me taë nga të pandehurit , është ofruar nga dëshmitarët –Qerim Camaj, Arif Arifaj dhe Gezim Broqi- të cilët ishin btë pranishëm tek stacioni i trenit në ditën kritike. Ata në mënyrë unanime kujtuan se gruaja po mbante uniformë ushtarake. Njëri nga ata poashtu kujtoi se që të tretë, së bashku, shkuan tek vozitësi i taksisë për t'a angazhuar atë. Kjo është e rëndësisë domethënëse edhe për faktin se verzioni i të pandehurve është jo i vërtetë dhe poashtu për faktin se ata kanë paravendosur një plan që të kryejnë veprë penale)

5. Pranimet nga të pandehurit(sa i përket fakteve se ata vishin të pranishëm në taksi deri në momentin e krimit dhe se rezultat i agresionit ishte vrasje e Ejup Broqit)ofrojnë vërtetim domethënës pjesës kryesore të deklaratave të Sherif dhe Faruk Zekës dhe Teuta Hotit.

6. Tanimë janë dhënë arsyet se përse nuk është e besueshme që Teuta Hoti të ketë mundur të fabriktoj akuzën kundër të pandehurve si hakmarrje;

7. Përfundimisht, duhet të theksohet se vetura e Ejup Broqit, pas ditës së vrasjes, mbeti në posedim të Bekim Zekës, i cili ishte parë nga disa persona duke vozitur Opel Askonën e kuqe gjatë muajve pas ngjarjeve. Bekim Zeka personalisht në mënyrë kuptimplotë pranoi përdorimin e asaj veture pas ngjarjeve kritike.

Është e një vlere të madhe dëshmuese se në koincidence me vdekjen e Ejup Broqit vetura e tij kaloi në duart e Bekim Zekës: kjo është madje edhe më e vërtetë nëse e marrim parasysh se kjo është në mënyrë të përkryer në linjë me përshkrimin e ngjarjeve të dhënë nga Teuta Hoti (e cila deklaroi se vrasja ndodhi me qëllim që të vidhet taksija).

Për arsyet e mësipërme deklaratat defanzive të Bekim dhe Arben Zekës nuk e bindën Trupin gjykues për pafajësinë e tyre.

Është e përshtatshme të shtohet se, në mënyrë specifike lidhur me vlerësimin e besueshmërisë e brendshme të mrbojtjeve të tilla:

- Se deklaratat e bëra nga secili prej të pandehurve në faza të ndryshme të procedurës janë shumë shpesh jo koherente me njëra tjetrën: mospërputhshmëritë

janë të numërta dhe relevante dhe të pandehurit nuk ishin në gjendje të orfojnë shpjegim për atë;

- Se përmbajtja e deklaratave të pandehurve nuk është në disa aspekte *per se* e besueshme. Në veqanti:
 - paraqitet që nuk ngjan që Arbeni të jetë larguar menjëherë nga vendi i krimit sapo që filloi rrahja në mes të vëllait të tij dhe vozitësit të taksisë, pa tentuar madje as të parandalohet ajo.
 - paraqitet se nuk ngjan që Bekimi e la Arbenin duke u rrahur me taksistin, madje edhe për më tepër sepse përfundimisht është Bekimi ai që ishte parë gjithmonë në posedim të Opel Askonës;
 - mbetet plotësisht e pashpjegueshme nga të pandehurit arsyeja se pse ata e ndjen vehten që kishin të drejtë të mbajnë në posedim veturën e viktimës pas vrasjes.

Atëherë, nuk ka dyshim, sa i përket kryerjes së veprës *actus reus* nga të pandehurit.

Nuk mund të ketë dyshim për ekzistimin e *mens rea*.

Ekzistojnë prova, në fakt, jo vetëm për synimin për të vrarë, por poashtu për paramendimin e vrasjes dhe për përgatitjet për të.

Modalitetet e ekzekutimit të krimit, nuk janë rastësisht, plotësisht konsekuente me planin që ishte sajuar.

Nuk ishte e mundur gjatë shqyrtimit kryesor që të konstatohet nëse vrasja ishte kryer pas një urdhëri nga ndonjë bashkëfajtor (si do të kishte gjasë të paraqitet, duke marrur parasysh brutalitetin e krimit dhe përfitimin e ulët nga të pandehurit përmes një sjelljeje aq të pamëshirshme). Kjo mund të jetë poashtu objekt i hetimeve të mëtutjeshme nga Zyra e Prokurorit Publik.

Gjatë shqyrtimit kryesor kurrfarë elementesh shfajësues nuk janë theksuar (apo madje pretenduar) nga të pandehurit.

Bekim dhe Arben Zeka duhet, në përfundim, të mbahen përgjegjës për vrasjen e Ejup Broqit.

3.9 Dënimi

Kur vendos për dënimin gjykata duhet të marrë parasysh modalitetet e kryerjes së veprës penale dhe personalitetin e të pandehurit. Dënimi poashtu duhet të jetë pengues në mënyrë të duhur i krimeve të metutjeshme dhe sanksion proporcional për veprën e cila ishte kryer.

Lidhur me modalitetet e zhvillimit dhe karakteristikave objektive të veprës penale të kryer nga Bekim dhe Arben Zeka, duhet të merret parasysh se të pandehurit vepruan në një mënyrë jashtëzakonisht brutale.

Ata me gjakftohtësi e sulmuan viktimën (të cilin madje as që e njohën personalisht) në një moment në të cilin ai madje as nuk ishte në gjendje të mbroj veten.

Kapaciteti i viktimës për t'u mbrojtur më tutje ishte zvogëluar nga fakti se sulmuesit e mundën atë numerikisht.

Ata zgjodhën rrethanat e hapësirës (brenda taksisë, dhe në një vend të braktisur) dhe kohës të cilat ku ata me lehtësi mund t'i realizonin synimet e veta dhe të cilat nuk ngjanin të zbulojnë veprat e tyre ndaj të tjerëve: kjo tregon një përcaktim të veqantë që të arrihet synimi i tyre kriminal (dhe andaj një kapacitet më i lartë kriminal).

Ata planifikuan paraprakisht krimin dhe në të e përfshien një vajzë 15 vjeçe, duke i dhënë asaj një rol në planin.

Ata vendosën të vrasin një person me qëllim që të arrijnë një përfitim ekonomik qesharak; vrasja për më tutje, ishte gjallëruar nga urrejtja etnike (viktima ishte zgjedhur për shkak të përkatësisë së tij "Serb apo Rom").

Kjo është posaqërisht domethënëse sa i përket vlerësimit të konsideratës zero të të pandehurve ndaj jetës njerzore dhe , andaj, për vlerësimin e rrezikshmërisë së tyre për shoqërinë.

Trupi gjykues ishte impresionuar nga përcaktimi i treguar nga të pandehurit në kryerjen e vrasjes: përkundër rrahjes së viktimës për kohë të gjatë, gjatë cilës kohë ai qau dhe kërkoi mëshirë, të pandehurit e ekzekutuan atë pamëshirshëm. Kjo është më tepër impresive nëse mendojmë se të pandehurit madje as që e njohën viktimën më heret dhe nuk patën motive t'a vrasin (po të mos ishte motivi qesharak i përfitimit ekonomik). Përfundimisht, ata filluan të përdorin veturën e tij në qytet ku familja e viktimës jetonte.

Provat e mbledhura janë të qarta në tregimin se sjellja e të pandehurve ishte e paramenduar, kjo më tutje e rëndon atë.

Faktet se ngjarjet ndodhën në Kosovë pas fundit të luftës , në një peiudhë kur situata socio politike në Kosovë nuk ishte e lehtë, nuk është rrethanë lehtësuese. Vrasja, në fakt, nuk pati të bëj asgjë fare me çështjet politike në fjalë në ato kohë dhe të pandehurit ishin duke vepruar ekskluzivisht për interesin e tyre ekonomik.

Arsyetimi i sipërpërmendur e çoi trupin gjykues në aplikimin e dënimit me burgim në shkallën maksimale.

Sipas nenit 22 të Ligjit Penal Të Jugosllavisë (1977), “nëse të pandehurit bashkarisht kryejnë veprën penale duke marrur pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili nga ata do të dënohet siç parashihet për atë vepër”.

Është e mundur për trupin gjykues, megjithatë, të llogaris dënimin në mënyrë të ndryshme për secilin pjesëmarrës, duke i marrur parasysh elementet subjektive dhe kontributin e ndryshëm material në kryerjen e veprës.

Trupi gjykues mendon se kontributi i Bekim Zekës në kryerjen e krimit ishte më i shquari. Kështu që ai meriton dënim më të ashpër.

Në fakt:

- ai ishte pronari i pistoletës që shërbeu në kryerjen e krimit
- ai ishte i pari që pati idenë e krimit.
- Ai mëpastaj ishte parë në posedim të veturës që ishte vjedhur prej viktimës;
- Ai ishte konsideruar nga Teuta Hoti si karakteri udhëheqës dhe personi që luajti rolin kryesor në kryerjen e veprës.

Andaj do të ishte jo e drejtë të dënohet Arben Zeka me ashpërsinë e njejtë.

Sipas ligjit, dënimi me burgim mund të ndryshoj mes minimumit të dhjetë vjetëve deri në maksimumin e pesëmbëdhjetë vjetëve. Per rastet më serioze është e mundur të aplikohet dënimi nga 20 vjet. Nuk është e mundur, sipas ligjit ekzistues, të dënohet dikush me burgim mes 15 dhe 20 vjetëve.

Trupi gjykues e konsideron të përshtatshëm dënimin nga pesëmbëdhjetë vjet burgim për të pandehurin Arben Zeka dhe (duke patur parasysh rolin më të madh të luajtur nga ai) dënimin prej njëzet vjet burgim për të pandehurin Bekim Zeka.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet brenda dënimit të shqiptuar.

3.10. Kërkesa pronësore

Në ndëgjimin e parë, pala e dëmtuar Shukrije Broqi kërkoi mbrojtje gjyqësore të të drejtave të saj gjatë këtij shqyrtimi.

Ajo përsëriti kërkesën e saj me rastin e deklaratave përfundimtare, duke dorëzuar një dokument me shkrim.

Vdekja e burrit përbën vepër të rëndë civile për Shukrije Broqin, marrë parasysh afërsinë e marrëdhënies me viktimën.

Ajo ishte lënë vetëm me disa djem, pa të ardhura që të mbaj vehten dhe të përkrah arsimimin e djemve të saj.

Ajo ishte privuar nga marrëdhënia personale më e afërt, gjatë një kohe veqanërisht të rëndë (Kosova atëherë sapo kishte dalë nga lufta).

Shukrije Broqi ka, andaj, të drejtë për kompenzim të duhur për dëmin e pësuar, i cili është i dyfishtë: dëm moral për humbejn e marrëdhënies dhe dëmin financiar për humbjen e mjeteve dhe të ardhurave ekonomike.

Procedura e provave, megjithatë, nuk mundi t'i ofroj trupit gjykues një dëshmi të plotë të dëmit i cili i është shkaktur palës së dëmtuar.

Është megjithatë e domosdoshme që asaj t'i ofrohet kompenzim i pjesshëm, duke e drejtuar atë tek gjykatësi civil për përcaktim të sasisë të pjesës së mbetur për dëmin e pësuar.

Trupi gjykues mendon se është e përshtatshme që të ndëshkohet secili nga të pandehurit për pagesën e shumës nga 10.000,00 EUR palës së dëmtuar.

Për pjesën tjetër, pala e dëmtuar ishte udhëzuar që të parashtroj një padi tek gjykatësi civil, ku provat e plota të dëmit të pësuar do të jenë të mundshme.

Me datë, 1 Korrik 2008

E përgatitur në gjuhën Angleze, një gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtësja Ndërkombëtare
Vlora Johnston

Gjykatësi Kryesues Ndërkombëtar
Ferdinando Buater de Mongeot

MJETET JURIDIKE:

Ankesa duhet të paralajmërohet brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe duhet të parashtrohet tek gjykata e shkallës së parë, në përputhje me nenin 398 paragrafi (1) i KPPK. Personi i autorizuar mund t'i parashtroj ankesë kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut të Pejës/ Pec Gjykatës Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data kur kopja e këtij aktgjykimi të jetë dorëzuar.